 99. Dosje formulare nr. 12627, në ngarkim të A. P., me 70 (shtatëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit Ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

100. Dosje me korespondenca të asgjesuara 1949-1973, me 225 (dyqind e njëzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket Fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Tropojë.
101. Dosje me procesverbalet e asgjesimit e të dhënave nga dosja e informatave, me 490 (katërqind e nëntëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket Fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Tropojë.
102. Dosje me procesverbalet e asgjesimit të përpunimeve viti 1980-1991, me 244 (dyqind e dyzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket Fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Tropojë.
103. Dosje me procesverbalet e asgjesimit të bashkëpunëtorëve viti 1980-1991, me 194 (njëqind e nëntëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket Fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Tropojë.
104. Fashikull nr. 2680/25 në ngarkim të N. A., me 74 (shtatëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Fashikulli i përket Fondit Ish Të Arratisur.
105. Fashikull me vendime asgjesimi të bashkëpunëtorëve, lista veçimi të bashkëpunëtorëve dhe statistika viti 1986-1987-1988, me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Fashikulli i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
106. Dosje me listë veçimi dhe procesverbale asgjesimi të bashkëpunëtorëve, me 35 (tridhjetë e pesë). Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
107. Dosje për asgjesimin e materialeve të agjenturës, me 43 (dyzet e tre). Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
108. Dosje me vendime për heqjen nga përpunimi, me 6 (gjashtë). Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
109. Dosje me materiale të ndryshme për asgjesim të përpunimeve, me 37 (tridhjetë e shtatë). Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
110. Dosje me materiale të ndryshme për asgjesim të përpunimeve, me 60 (gjashtëdhjetë). Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
111. Dosje me materiale të ndryshme për asgjesim të përpunimeve, me 36 (tridhjetë e gjashtë). Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
112. Dosje me materiale të ndryshme për asgjesim të përpunimeve, me 91 (nëntëdhjetë e një). Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
113. Dosje me procesverbale për asgjesimin e dosjeve të përpunimeve e kartelave model 1 e 3, me 235 (dyqind e tridhjetë e pesë). Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
114. Regjistër agjente nr. 1, Grupi II-të, Model 2, me 142 (njëqind e dyzet e dy) fletë, fillon me nr. rendor 1 dhe mbaron me numrin rendor 5719, në total janë 141 (njëqind e dyzet e një) fletë të plotësuar. Niveli i klasifikimit të regjistrit është "Tepër Sekret". Regjistri daton në vitet 1949-1988. Propozojmë deklasifikim të plotë të regjistrit nga numri rendor 1 deri në numrin rendor 5719, që përkon me 141 (njëqind e dyzet e një) fletë. Regjistri i përket fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.
115. Fashikull me listë veçimi të përpunimeve nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, me 97 (nëntëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.
116. Fashikull me listë veçimi të bashkëpunëtorëve nr. 61, nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, me 214 (dyqind e katërbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.
117. Fashikull me listë veçimi të bashkëpunëtorëve nr. 69, nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5 dhe nr. 6, me 132 (njëqind e tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

118. Fashikull me listë veçimi të bashkëpunëtorëve nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, me 107 (njëqind e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.
 119. Fashikull me listë veçimi të bashkëpunëtorëve nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4 viti 1991, me 104 (njëqind e katër) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.
 120. Fashikull me listë veçimi të përpunimeve nr. 1 – nr. 16 viti 1989, me 272 (dyqind e shtatëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.
- I. Marrjen në shqyrtim për deklasifikimin pjesësisht të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" që gjendet në dokumentin si më poshtë:
1. Regjistër agjente Model 2, me 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) fletë, fillon me nr. rendor 226/2 dhe mbaron me numrin rendor 16214, në total janë 57 (pesëdhjetë e shtatë) fletë të plotësuara. Niveli i klasifikimit të regjistrit është "Sekret". Regjistri daton në vitet 1948-1992. Propozojmë deklasifikim të pjesshëm të regjistrit nga numri rendor 226/2 deri në numrin rendor 8012 datë 3.2.1991, që përkon me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Regjistri i përket fondit Ish Dega e Punëve të Brendshme Fier.
 2. Regjistër agjente Model 2, me 188 (njëqind e tetëdhjetë e tetë) fletë, fillon me nr. rendor 60 dhe mbaron me numrin rendor 16214, në total janë 187 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë) fletë të plotësuara. Niveli i klasifikimit të regjistrit është "Sekret". Regjistri daton në vitet 1958-1991. Propozojmë deklasifikim të pjesshëm të regjistrit nga numri rendor 60 deri në numrin rendor 16211, që përkon me 186 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) fletë. Regjistri i përket fondit Ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

KRYETARE E KDZH-së

Dr. Gentiana Sula



VEPRIMTARI

TË AUTORITETIT PËR
INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH SIGURIMIT TË SHTETIT
PËR PERIUDHËN
SHTATOR-TETOR 2021

KRYETARJA E AUTORITETIT TAKIM ME PËRFAQËSUES TË AMBASADËS AMERIKANE



Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula u takua me z. Keith West, Ambasada e SHBA në Shqipëri, me të cilin u diskutua për rolin e Autoritetit në fushën e drejtësisë tranzicionale, hapjen e dosjeve, praktikat institucionale, individuale e studimore, proceset që lidhen me të drejtën për informim, të zhdukurit në komunizëm, etj.

Ambasada e SHBA mbetet partner i rëndësishëm i AIDSSH dhe veprimtarisë së tij për zbardhjen e së shkuarës.

AIDSSH-OSBE, BASHKËPUNIM PËR DREJTËSINË TRANZICIONALE



Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe AIDSSH bashkëpunuan për tri javë radhazi, për trajnimin e lektorëve të Fakultetit të Drejtësisë, që do të angazhohen në mësimdhënie në programin Master në Drejtësi Transitore.

AIDSSH bën pjesë në bordin këshillimor të Qendrës për Drejtësi e Transformim dhe mbështet kërkimet për të shkuarën komuniste në materialet e veta arkivore.

PREZANTOHET BOTIMI I AIDSSH “E VËRTETA E INXHINIERËVE TË KËNETËS SË MALIQIT” TË PAGJETURIT E ZONËS SË MALIQIT

Më 16 shtator 2021, AIDSSH prezantoi në Bashkinë Maliq botimin “E vërteta e inxhinierëve të kënetës së Maliqit”, ku zbardhen materialet e Sigurimit mbi grupin e dënuar dhe stigmatizuar si “sabotator”, në vitin 1946.

Bashkia Maliq hapi dyert e saj për të hedhur dritë në të vërtetën e inxhinierëve të Maliqit dhe grupimit të dënuar me ta, shqiptarë e të huaj, duke bërë një hap përpara në ridimensionimin e figurës së tyre.



Ekspozita “E shkuara e pakryer”, me profile të të zhdukurve në komunizëm, u prezantua edhe për qytetarët e Maliqit, në mjediset e jashtme të Bashkisë. Po ashtu, dëshmitë e mbledhura nga AIDSSH të familjarëve të të pagjeturve.

Botimi “E vërteta e inxhinierëve të kënetës së Maliqit”, i punuar nga historianë dhe me dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, bëhet i njohur për shoqërinë dhe të rinjtë, me materialet arkivore të shfrytëzuara mbi historinë e shtrembëruar në vite nga politika dhe propaganda.

Kryetari i Bashkisë Maliq, z. Gëzim Topçiu dhe Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula hapën takimin, që është i pari i Dialogut të Maliqit. Në muajt e ardhshëm, një pllakatë që përkujton jetët në tharjen e kënetës së Maliqit, do të vendoset nga bashkia në zonë, në bashkëpunim me institucionet dhe familjet.

Prof. Asoc. Dr. Sonila Boçi e Institutit të Historisë në Qendrën e Studimeve Albanologjike mbajti fjalën e saj mbi studimin “Dënimi i inxhinierëve të kënetës së Maliqit, pjesë e justifikimeve për dështimet e regjimit komunist” mbi dosjet e Sigurimit mbi inxhinierët e Maliqit.



Në vijim, znj. Liliana Çoçoli e AIDSSH bëri një paraqitje të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit mbi inxhinierët e dënuar. Znj. Çoçoli është mbesa e inxhinierit të mirënjohur, Kujtim Beqiri, ende pa varr. Z. Simon Mirakaj, anëtar i AIDSSH foli mbi dëshmi të të dënuarve në Maliq, të cilët i kanë publikuar kujtimet e “kampit të vdekjes”, siç u mbiquajt kampi i Orman Pojanit në Vloçisht.

Të rinj të Maliqit interpretuan pjesë të poemës “Kanali” të Arshi Pipës, i dënuar në kampin burg të Vloçishtit, me intelektualë të tjerë, mes të cilëve, Mitrush Kuteli, Jusuf Vrioni, Sami Repishiti, Halit Selfo, Vexhi Buharaja, Pashko Gjeçi, Sulejman Vuçitërna, Hafiz Ali Kraja, Atë Josif Papamihali, sot martir, etj.

Aktiviteti u zhvillua me pjesëmarrjen e familjarëve të të pagjeturve të komunizmit në zonën e Korçës dhe Maliqit; përfaqësues të komuniteteve fetare të zonës, shoqatave të të përndjekurve dhe kujtesës, përfaqësues të grupeve të interesit, znj. Dhorina Theodhori, Prokurore e Korçës, z. Ardian Çipa, Drejtor i Policisë Rajonale Korçë, Luigj Ndou, Përfaqësues i ICMP për Shqipërinë, përfaqësuesve të BE, aktorëve të shoqërisë civile, gazetarëve dhe të rinjve.

Diskutime të të pranishmëve mbi librin, udhërrëfyesin për familjarët e të zhdukurve dhe hapat e pritshëm konkretë u zhvilluan në mbyllje të takimit, ku u shpërndanë botime të AIDSSH “E vërteta e inxhinierëve të kënetës së Maliqit”, kopje të udhërrëfyesit dhe u plotësuan formularë ku raportohen të pagjeturit e regjimit komunist.

Takimi u zhvillua në kuadër të projektit të ICMP-AIDSSH “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzitore dhe pajtuese: adresimi i çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste”, i mbështetur nga Bashkimi Europian dhe Ambasada Zvicerane.



Kënetat e Maliqit zinte një sipërfaqe shumë të madhe toke dhe ishte bërë burim sëmundjesh malarike për zonën. Plani për tharjen e saj ishte hartuar në vitin 1936, nga inxhinieri italian Angelo Omodeo, në përfundim të të cilit parashikoheshin të thaheshin 4500 ha tokë dhe të bonifikoheshin 4500 të tjera. Në fillim të vitit 1946, Ministria e Punëve Botore, e bazuar në projektin e Omodeos, hartoi një plan pune për tharjen e kënetës së Maliqit, pa një studim paraprak mbi planin e Omodeos. Koha tregoi se një studim mbi projektin kishte qenë shumë i nevojshëm.

Më 29 mars 1955, Qeveria Amerikane paraqiti në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, në sesionin e Këshillit Ekonomik e Shoqëror, raportin me objekt “Evidenca e ekzistencës të punës së detyruar në Shqipëri”, ku flitet mbi punën e detyrueshme ose punën me “përdhunë” (siç edhe e cilëson raporti i qeverisë amerikane), bërë nga të burgosurit politikë shqiptarë në “kampet e vdekjes” (citim i raportit).

“Qeveria shqiptare nuk bënë asnjë tentativë për të fshehur faktin se ajo kërkon punë të detyruar nga persona kundërshtarë politikë dhe “dembelë”, shumica e të cilëve janë nga klasa ish- borgjeze ose pronarë tokash.” citon raporti i Qeverisë Amerikane në sesionin e OKB-së të 1955.



Raporti amerikan cilëson se “në dekadën e parë të qeverisjes së komunistëve (1944-1954) u ngritën 40 burgje politike dhe kampe koncentrimi, në të cilët kanë kaluar 80 mijë burra, gra e fëmijë nga të cilët, 16 mijë kanë humbur jetën. Në vitin 1954 punojnë 15 mijë të burgosur politikë në kampe koncentrimi, që përfshijnë ndërtime hidrocentralesh, rrugësh, tharje kënetash.”

Ky raport u përcoll me shqetësim nga Ministri i Jashtëm i Republikës Popullore të Shqipërisë, i cili në shkresën dërguar Komitetit Qendror të Partisë së Punës e konsideron “çpifje në lidhje me të ashtuquajturën ‘punë të detyruar’ në vendin tonë”.

CEREMONI NDERIMI NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË SH. T. Z. ILIR META



Presidenti i Republikës së Shqipërisë Sh. T. Z. Ilir Meta nderoi me Titullin e lartë “Martir i Demokracisë” propozimet e AIDSSH: Ylber Merdani, Shpresa Merdani, Nevrus Golka dhe Petrit Bazelli. Ceremonia u zhvillua më 17 shtator 2021, në ndërtesën e Këshillit të Qarkut Korçë, dikur gjykatë.

“VATRA” E SHQIPTARËVE U JEP “MIRËNJOHJEN E ARTË” ZNJ. GENTIANA SULA DHE Z. SIMON MIRAKAJ



Federata Panshqiptare “Vatra” në SHBA vlerësoi kontributet e kryetares dhe anëtarit të Autoritetit në zbardhjen e krimeve të komunizmit, zbulimin dhe evidentimin e historive të kampit famëkeq të Tepelenës ku vuajtën shumë të pafajshëm.

Autoriteti bashkëpunon që prej krijimit të tij me Federatën “Vatra” dhe bashkësinë shqiptare në SHBA, duke institucionalizuar marrëdhënien për ndricimin e se shkuarës dhe punuar për projekte të përbashkëta, mes të cilëve, kthimi në vend kujtese i kampit të Tepelenës.

TAKIME PËR DIALOGUN E TIRANËS



Autoriteti dhe partnerët vijojnë takimet e punës për përgatitjen e Dialogut të Tiranës, me ekspozitë dokumentare, mbledhje të dëshmimeve gojore, studim në dosje të Sigurimit të Shtetit, botime, faqe interaktive...

Me mbështetjen e gjerë të komunitetit, po punohet për aktivitetin lançues të datës 18 nëntor.



Autoriteti dhe partnerët, Shoqata Tirana, Instituti i Historisë në ASA, Universiteti Europian i Tiranës e të tjerët në këtë projekt, mirëpresin ide, sugjerime dhe mbështetje për ndricimin e gjysmëshekulli historik të Tiranës, ku u luajtën fatet e familjeve autoktone dhe të të gjithë vendit.

Sfida është e të gjithëve.

AMANETET E MARK SHLLAKUT, MËSUESIT 31 VJEÇAR, TË EKZEKUTUAR NGA REGJIMI KOMUNIST.



Më 30 shtator 2021, Kryetarja e Autoritetit Znj. Gentiana Sula, Sekretari i Përgjithshëm, z. Skënder Vrioni, në lidhje direkte me emisionin “Shqipëria Live” në Top Channel folën për çështjen e të zhdukurve në komunizëm, problematikat dhe veprimet që Autoritetet duhet të ndërmarin.

Të ftuar në studio, Anton Dukagjini, nipi i Mark Shllakut mësuesit që ende sot nuk i janë gjetur eshtrat dhe Simon Mirakaj, anëtar i Autoritetit, folën për letrat dhe amanetet e tij të fundit.

“URTËSIA E TRAUMËS” TË DR. GABOR MATE



Më 8 tetor, në sallën Aula Magna të Fakultetit të Shkencave Sociale u shfaq filmi “Urtësia e Traumës” të Dr. Gabor Mate .si bashkëpunim i Fakultetit me Autoritetin.

Mbajtën fjalët e rastit, znj. Arjana Muçaj, shefe e departamentit të Shkencave Sociale, znj. Gentiana Sula, kryetare e Autoritetit dhe z. Ervin Muço, i Institutit të Studimeve Europiane.

Trauma e përjetuar në kohë dhe forma të ndryshme është një forcë e padukshme që formëson jetën tonë,

mënyrën se si jetojmë, mënyrën se si e duam dhe mënyrën sesi i japim kuptim botës.

Është në rrënjë të plagëve më të thella. Trauma e paadresuar vazhdon të përjetësojë modele të dhimbshme.

Në këtë kuadër, filmi i përzgjedhur - i cilësuar si film i rëndësishëm për kohën që jetojmë - adresoi pikërisht këtë fenomen, nga specialisti më i mirë sot si Dr. Maté.

Në “Urtësinë e Traumës”, Dr. Gabor Maté ofron një vizion të ri: një shoqëri të informuar për traumat.

Një shoqëri në të cilën prindërit, mësuesit, mjekët, politikanët dhe stafi gjyqësor nuk merren me rregullimin e sjelljeve, shtypjen e simptomave, gjykimin dhe dënimin.

Në vend të kësaj, ata kërkojnë të kuptojnë burimet e sjelljes shqetësuese dhe sëmundjeve në shpirtin e lënduar të njeriut.

TAKIM ME STUDIUES TË PROJEKTIT SHKENCOR “FYTYRAT E SË SHKUARËS: LUFTA PËR LIRI DHE DEMOKRACI GJATË REGJIMIT TË ENVER HOXHËS”



Projekti shkencor “Face from the past: The fight for freedom and democracy during the regime of Enver Hoxha”, i mbështetur nga Bashkimi Europian, është një bashkëpunim i Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës dhe organizatës joqeveritare lokale “Zëri qytetar”, me partnerë ndërkombëtarë Universitetin “La Sapienza” të Romës, Centro Nazionale di Ricerca, Fondazione di Storia di Vincenza. I gjithë ekipi i studiuesve shqiptarë dhe të huaj zhvilloi një takim në mjediset e Autoritetit, krahas kërkesës së paraqitur nga studiuesit, për dokumentacion mbi vendet e internimit në Lushnjë, ish-Ndërmarrjen “28 Nëntori”, personalitetet e dënuara në këtë zonë e më gjerë.

Autoriteti ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës, që inkurajon kërkimin shkencor gjatë viteve 1944-1991 në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Profesorët e nderuar ndanë përvoja mbi qasjen ndaj kujtesës dhe kujdesin me të cilin duhet trajtuar narrativa e së shkuarës, sidomos sa u takon sistemeve totalitare. Bashkëpunimi do të vijojë me projekte të ndërsjella mbi përkujtimin, informimin dhe vendet e kujtesës.



VIZITË PUNE NË INSTITUCIONIN HOMOLOG POLAK, INSTITUTI I KUJTESËS KOMBËTARE, IPN



Nga data 11-15 tetor 2021, një delegacion i zgjeruar ndër-institucional, me përfaqësues të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Kuvendit të Shqipërisë, Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Përgjithshme, Institutit të Mjekësisë Ligjore, dhe gazetarë të mirënjohur, zhvilloi një vizitë pune në institucionin homolog polak, Instituti i Kujtesës Kombëtare, IPN. Ekipi i AIDSSH ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me IPN, sa i takon përvojës me arkivat, punës me kujtesën dhe kontributit për të zhdukurit. Përgjatë këtij viti pandemie, disa workshope të përbashkëta u organizuan online, duke mbështetur këtë bashkëpunim.



Në korrik 2020, ligjvënësi bëri disa ndryshime në ligjin funksional të Autoritetit, 45/2015, sa i takon edhe punës për të zhdukurit. Konkretisht, neni 22/1, Bashkëpunimi për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, si dhe masat për ruajtjen e vendvarrimeve, ku Autoriteti bashkëpunon me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për marrjen e masave për të mbrojtur dhe ruajtur në mënyrën më të përshtatshme vendet që janë aktualisht apo do të identifikohen si vendvarrime. Sipas ligjit, rregullat e bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit dhe institucioneve qendrore dhe vendore

për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të zhdukur gjatë komunizmit parashikohen në marrëveshje dy apo shumëpalëshe të lidhura për këtë qëllim. Autoritetet përgjegjëse dhe mënyra e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuar ose të dyshuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Para propozimit dhe miratimit të VKM përkatëse, delegacioni ndër-institucional e vizitoi IPN me fokus punën për të pagjeturit e komunizmit, për t'u njohur me protokollet për identifikimin dhe gjetjen e të zhdukurve, vendet e kujtesës, muzetë, vendvarrimet dhe të gjitha proceset e punës të lidhura me ta, të konsoliduara prej dy dekadash nga homologu polak, procese për të cilat Autoriteti mund të bashkëpunojë në të ardhmen, me institucionet e tjera qendrore dhe vendore.



Një program i ngjeshur u përgatit nga AIDSSH dhe homologët polakë, me workshope, takime me prokurorë, arkivistë, antropologë, ekspertë të komunikimit, vizita në site të hapura, dhe takime të nivelit të lartë me drejtues të IPN.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit u përfaqësua me z. Marenglen Kasmi, Anëtar i Autoritetit; z. Skënder Vrioni, Sekretar i Përgjithshëm; znj. Ardita Repishti, Drejtoreshë e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, z. Selami Zalli, Drejtor i Informacionit dhe znj. Ardiana Topi, Drejtoreshë e Arkivit të AIDSSH. Kuvendi i Shqipërisë u përfaqësua nga znj. Orjola Pampuri dhe z. Klevis Xhoxhi.

Policia e Shtetit, nga zv/drejtori, z. Albert Dervishaj, Prokuroria e Përgjithshme nga znj. Anila Leka, Instituti i Mjekësisë Ligjore nga z. Admir Sinamati. Gazetarët e mirënjohura, znj. Klodiana Lala dhe znj. Fatmira Nikolli u mbështetën nga Prezenca e OSBE-së në Tiranë dhe Fondacioni Konrad Adenauer.

Udhëtimi i të gjithë ekipit, në kohë kufizimesh lëvizjeje për shkak të pandemisë, u koordinua nga AIDSSH, me mbështetjen e Ambasadës Polake në Tiranë, Ambasadës Shqiptare në Varshavë, pasi u vu në dijeni për qëllimin dhe përbërjen e delegacionit, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme.

Programi i punës, i rakorduar më herët me homologët polakë të Institute of National Remembrance - Instytut

Pamięci Narodowej, IPN, u zhvillua në datat 12, 13, 14 tetor 2021, pranë zyrave të Institutit, të vendosura në pika të ndryshme të Varshavës, në sit zhvarrimi, në burgjet e komunizmit, vendet e izolimit dhe hetuesisë, sot muze e memoriale që zbardhin të shkuarën e afërt dhe nderojnë dinjitetin njerëzor.



Më 12 tetor, pranë zyrave të IPN delegacioni shqiptar u prit në takim nga znj. Agnieszka Jedrzak, Drejtuese e Departamentit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, pranë Presidentit të IPN, e cila i njohu me programin, dhe dinamikat e ditëve në vijim.

Shkëmbime botimesh në gjuhën angleze, mbi studimin e shtypjes komuniste dhe punën me të pagjeturit u bënë që në takimin e parë në IPN dhe në ditët në vijim, nga departamentet e ndryshme, me punën e të cilëve u njoh ekipi shqiptar.

Znj. Jedrzak, prezantoi punën duke folur për organizimin e Institutit polak, një institucion me 2400 punonjës me 11 zyra lokale nëpër qytete të tjera të Polonisë përveçse në Varshavë,

e ndarë në disa sektorë kryesorë, mes të cilëve: arkivi, prokuroria, kërkimi shkencor, lustracioni, edukimi, përkujtimi e nderimi i heronjve.

Njohja me arkivin e institucionit, proceset e punës, përfshirë digjitalizimin, restaurimin, ekspozitat dokumentare dhe komunikimin e gjetjeve publikut, u realizuan ditën e parë të vizitës, ku delegacioni shqiptar u prit nga Drejtoresha e Arkivit të IPN, znj. Marzena Kruk.



Po ashtu, vizita në Muzeun e Ushtarëve të Ndëshkuar dhe të Burgosurve Politikë, ish-burg i njohur në Varshavë që në fillim të shekullit XX, me të dënuar të Gestapos e komunizmit, histori të torturës, hetuesisë dhe dënimit me vdekje brenda mjediseve të tij, sot muze, në të cilin ishin përfshirë edhe gjetjet e zhvarrimeve të të burgosurve, një pjesë e tyre, sot të identifikuar nga sektori përkatës.

Gjetjet e kërkimeve ishin pjesë e ekspozitës me artefakte dhe të dhëna të mbledhura, e cila është një përvojë e rëndësishme në dokumentimin e punës për të pagjeturit.

Dita e dytë, 13 tetor, iu dedikua tërësisht punës me të zhdukurit. Në zyrat e edukimit të IPN, z. Robert Janicki, prokuror, Drejtues i Komisionit të IPN-së për Ndjekjen e Krimeve kundër Kombit Polak bëri një paraqitje të punës së 80 prokurorëve pranë IPN, që ndiqnin çështjet të lidhura me zhvarrimet e të pagjeturve të komunizmit. Seanca u zgjat mes pyetjeve e përgjigjeve mbi sfidat dhe arritjet e kësaj përvojë.

Z. Krzysztof Szwagrzyk, zv/President i Institutit të Kujtesës Kombëtare, njëkohësisht zv/ Drejtor i Kërkimit Shkencor dhe i Plotfuqishëm për krimet e kryera, hapi takimin e punës për kërkimin dhe identifikimin e të zhdukurve. Secili prej departamenteve bëri paraqitjen e punës, sfidave dhe arritjeve në një punë shumë të vështirë, me mungesa të theksuara dokumentacioni, por vullnet dhe qëndrueshmëri në kërkim.



Bashkëbisedimi dhe diskutimet për të gjitha fazat e punës, arkivore, arkeologjike, teknike, mjeko-ligjore, antropologjike e deri në komunikimin e gjetjeve publikut, ndërveprimin me të gjitha kategoritë shoqërore u mbyllën me vizitën e ekipit në Lëndinë, „Łączka”, në Powązkowski Cemetery, siti ku u zhvarrosën më shumë se 325 polakë që u ishte humbur dhe tjetërsuar varri.

Puna për zhvarrimin e tyre zgjati për disa vite, u mbështet në dëshmi, të dhëna gojore, dokumentacion të munguar e të plotësuar me burime historike e të dhëna të copëzuara dhe kontribut vullnetar të mbi 350 vetave që ndihmuan për rivarrimin e atyre që Polonia i quan heronj, kundërshtarëve të regjimit.



Ditën e tretë, 14 tetor, delegacioni u prit nga z. Karol Polejowski, zv/ drejtor i IPN, me të cilin u diskutua për vijimin e bashkëpunimit institucional të AIDSSH me IPN dhe hapave konkretë në këtë drejtim. Po ashtu, u lanë të hapura mundësitë e bashkëpunimit e të shkëmbimit të përvojës edhe me institucionet e tjera shqiptare, të cilat do të koordinojnë punën me Autoritetin.

Profesor Przemysław Gasztold, nga Departamenti i Kërkimit në IPN bëri një paraqitje të marrëdhënieve shqiptaro-polake, në dritën e doku-

menteve arkivore. Publikime të posaçme mbi këto marrëdhënie dhe rolin e shërbimeve sekrete në to janë në proces.

Delegacioni shqiptar e vijoi vizitën Shtëpinë Muze të IPN-së, në rrugën Strzelecka 8, një ndër dhjetëra shtëpitë e përdorura si burg, hetuesi dhe vend torturash në Varshavë, një pjesë e mirë e të cilave tregoheshin në këtë muze.

Botime, broshura, ekspozita që pritet të lëvizin në Europë në të ardhmen dhe informacion mbi procese të punës me interes të përbashkët u shkëmbyen edhe ditën e fundit të takimeve mes IPN dhe delegacionit ndërinstitucional shqiptar.

AIDSSH dhe IPN komunikojnë në kuadër të kujtesës nëpërmjet Rrjetit European të Arkivave të ish-Policive Sekrete, ku Shqipëria u anëtarësua së fundmi dhe Rrjetit European të Kujtesës dhe Solidaritetit.

Në vijim, i gjithë ekipi u prit në Ambasadën Shqiptare në Varshavë, nga znj. Shpresa Kureta, ambasadore e Shqipërisë. Znj. Kureta dhe stafi i saj bënë një paraqitje të punës së ambasadës në Poloni për forcimin e marrëdhënieve mes shtetit polak dhe atij shqiptar, të cilave, veç turizmit dhe kulturës, u shtohet reflektimi i dyanshëm për të shkuarën komuniste dhe qëndrimi ndaj saj.

Në mbyllje të vizitës, sfidat për trajtimin e çështjes së të zhdukurve mbeten për t'u shqyrtuar me kujdes e profesionalizëm nga secili prej institucioneve të përfshira.

Po ashtu, prezantimi i kauzave të tilla publikut, që janë po aq aktuale sa ngjarjet e ditës, si plagë të pambyllura të së kaluarës, me gjurmë të qenësishme në të sotmen.



SIMPOZIUMI EUROPIAN I KUJTESËS

A ekziston një kulturë e përbashkët evropiane e kujtesës?

A është e mundur të ndërtohet një narrativë e përbashkët historike në Europën e shekullit XXI?

Këto pyetje janë në qendër të diskutimeve ndërkombëtare mes studiuesve e akademikëve të historisë, aktorëve të kujtesës dhe të kulturës.

Mos të flasësh për “acquis historique communautaire” nuk është më shumë se fantazi?

A ekziston një kulturë e përbashkët evropiane e kujtesës, e cila në Europë na lejon që ta kuptojmë dhe të bashkëpunojmë më mirë me njëri-tjetrin?



Vjenë, Budapest, Bruksel, Bukuresht dhe Paris. Këtë vit, ENRS i mbledhi aktorët e kujtesës në Talin, Estoni, për simpoziumin e nëntë:

Qëllimi i Simpoziумit European të Kujtesës është shkëmbimi i përvojave dhe vendosja e formave të bashkëpunimit mes institucioneve të vendeve të ndryshme.

Përfaqësuesit e institucioneve historike evropiane ftohen të diskutojnë sfidat me të cilat përballet ideja e Evropës për kulturën e kujtesës. Takimet janë të hapura për të gjithë profesionistët që punojnë me historinë evropiane të shekullit XX.

Simpoziumi i parë i ENRS-së u organizua në Gdansk, në vitin 2012. Edicionet e mëpasme, në Berlin, Pragë,

Kujtesa dhe identiteti në Europë: e tashmja dhe e ardhmja

Synimi i Simpoziумit të nëntë European të Kujtesës ishte roli i historisë dhe kujtesës në krijimin e identitetit bashkëkohor evropian. Gjatë aktiviteteve, vëmendje e veçantë iu kushtua misionit, programit dhe praktikave më të mira të institucioneve që studiojnë dhe punojnë me historinë evropiane të shekullit XX.



Diversiteti i kujtesës evropiane është rezultat, ndër të tjera, i një periudhe të gjatë të shenjuar nga ndryshime kufijsh dhe konflikte, diktatura dhe akte terrori.

Gjatë dekadave të fundit, debatet historike dhe politikat e kujtesës në Evropë kanë qenë veçanërisht sfiduese. Përvojat e ndryshme në Lindje dhe Perëndim gjatë shekullit XX kanë formuar mjedise të paqarta të memories.

Diskutimet historike për Europën Lindore dhe Qendrore kanë qenë të vështira e komplekse, për shkak të përvojave

me dy regjime totalitare, të drejtuar nga ideologji komuniste dhe nacional-socialiste.

Simpoziumi i vitit 2021 në Estoni u zhvillua 30 vjet pas shpërbërjes së BRSS dhe ngjarjeve në rajon, që shënuan fundin e Luftës së Ftohtë. I pushtuar nga rusët dhe gjermanët, Gjermania Naziste dhe Rusia Sovjetike në shekullin e kaluar, Talini është shembull i historisë komplekse të shekullit XX, të asaj Europe që formësoi kujtesën dhe identitetin e njerëzve që jetojnë në të.

Çështjet e lidhura me historinë dhe përkujtimi i ngjarjeve dhe figurave të caktuara historike janë gjithnjë e më të spikatura në diskursin akademik, politik dhe publik.

Institucione të ndryshme, me larmi aktiviteteve, përpiqen të marrin pjesë në formësimin e perceptimit publik të historisë në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Mes projekteve të propozuara, disa nxisin dialog dhe mirëkuptim mes evropianëve, të tjerë veprojnë si instrumente për promovimin e stereotipeve ose për (ri) ndezur konfliktet.



Në dritën e zhvillimeve të fundit në diskutimet për historinë dhe identitetin në Evropë, institucione, organizata dhe individë që punojnë për edukimin historik, diskutuan sfidat e përditshme, përfshirë projektet e suksesshme dhe të dështuara. Po ashtu, një sesion i veçantë iu kushtua përmbledhjeve të shkurtra (të njohura si ‘prezantime turbo’) të projekteve inovative që kanë të bëjnë me historinë dhe kujtesën europiane. Partnerët kryesorë të ENRS të edicionit të vitit 2021 ishin Instituti Estonez i Kujtesës Historike dhe Instituti Federal për Kulturën dhe Historinë e Gjermanëve në Europën Lindore.

Dita u parë u hap me trajtimin e identitetit evropian sot: rrënjët historike dhe debatet aktuale. Perceptimet e shumëfishta të “identitetit evropian”, të formësuar nga implikimet e kujtesës historike u hodhën në diskutim për qasjet e ndryshme të politikave të përkujtimit dhe agentëve të tyre që nxisin ndërgjegjësimin historik në Evropë, duke reflektuar në pyetjet: A është ende e rëndësishme ndarja e pasluftës në blloqe komuniste dhe kapitaliste? A rezonon kjo në kultura të ndryshme të kujtesës makrorajonale, të rrënjësura në përvoja të përbashkëta historike?

Cfarë roli luan BE sot në krijimin e një identiteti të përbashkët në Europë?

Dr. Monika Kareniauskaitė, Dr. Michał Łuczewski, Prof. Viacheslav Morozov dhe Dr. Gergely Prőhle diskutuan sfidat e mësipërme me të pranishmit dhe ndjekësit nga rrjeti. Sesioni hapës u moderua nga Elazar Barkan dhe Prof. Toomas Hiio.

Në vijim, në format të përmbledhur, pjesëmarrësit paraqitën organizatat dhe projektet e tyre.

Dita e dytë e simpoziumit, iu kushtua kujtesës në veprim: sfidave të përditshme dhe rekomandimeve për të ardhmen.

Sesioni trajtoi opinione, rekomandime dhe sugjerime për të ardhmen e politikave të përkujtimit, të kuptuara gjerësisht në Europë. Përfaqësuesit më të lartë të institucioneve aktive në fushën e edukimit historik dhe kujtesës që veprojnë në nivel ndërkombëtar folën mbi përvojat e deritanishme dhe sfidat e përditshme të aktiviteteve të tyre, krahas rekomandimeve për të ardhmen.



Në diskutime morën pjesë drejtues të organizatave aktive në fushën e kujtesës në Europë, Observatori Evropian i Kujtimeve EUROM, z. Oriol Lopez Badell; Rrjeti Evropian i Përkujtimit dhe Solidaritetit, z. Rafał Rogulski; Muzeu Shtëpia e Historisë Europiane, znj. Constanze Itzel; Platforma Europiane e Kujtesës dhe Ndërgjegjes, Dr. Łukasz Kamiński.

Sesioni u moderua nga Sergei Metlev, i Institutit Estonian për Kujtesën Historike.

Në vijim, koordinatorët e projekteve edukative dhe sociale në fushën e historisë ndanë përvojat më të mira të praktikave, në

tre formate të organizuara sipas tematikave:

- 1) Ballafaqimi me një të kaluar të vështirë, me diskutimet e znj. Dorottya Baczoni, Muzeu i Shtëpisë së Terrorit dhe Dr. Keiu Telve, Muzeu Vabamu i Shtypjes dhe Lirisë.
- 2) Përfshirja e komuniteteve lokal e, me diskutimet e Dr. Gentiana Sula mbi dëshmitë gojore dhe rolin e tyre, krahas dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit, dhe Dr. Annemarie Franke dhe Anna Ęchoëiak, për projektin ndërkombëtar “In Between”?
- 3) Përdorimi i mediave/teknologjive të reja, me diskutimet e Paweł Sawicki, Muzeu i Aushvicit dhe Dr. Kristina Ranki, i Muzeut Mannerheim.

Sesioni i dytë u moderua nga znj. Beata Drzazga dhe Maria Naimska të ENRS.

Gjatë ditës u zhvilluan vizita njohëse në Memorialin për Viktimat e Komunizmit të Estonisë dhe Muzeun His-

torik Estonez, në burgun Patarei, dhe vizitë në qelitë e KGB-së, të lidhura me Muzeun Vabamu të Shtypjes dhe Lirisë.

Në panelin vijues, diskutimet u përqendruan në rishikimin e lëvizjeve të 1989, në dritën e dokumenteve dhe kërkimeve të fundit mbi ndryshimet e ndryshme politike, kulturore dhe ekonomike që lidhen me vitin 1989 në Europën Lindore-Qendrore.

Si ka ndryshuar kujtesa e tranzicionit gjatë 30 viteve të fundit? A kanë shkaktuar këto ndryshime interes kërkimor mbi këtë temë? Cilat janë ndryshimet rajonale?

Pjesëmarrës në panel, autorë të librave kushtuar transformimeve të vitit 1989, Dr. Tobias Rupprecht, Dr. Lars Fredrik Stöcker, Dr. Paweł Ukielski, me moderimin e Dr. Peter Jašek.



Dita e tretë u përqendrua te përballja me të kaluarën: kujtesa dhe politika. Sesioni trajtoi polemikat që lidhen me një kulturë të përbashkët përkujtimore në Europë, të karakterizuar nga përvoja të ndryshme dhe vlerësime subjektive: në çfarë termash, - perceptimet e ndryshme të shteteve kombëtare dhe grupeve kolektive në Europën Lindore dhe Perëndimore për regjimet totalitare, -tingëllojnë si politizim i kujtesës? A ka dallime në përkujtimin e holokaustit në Europën Perëndimore dhe Lindore? Cilat janë arsyet e popullaritetit të komunizmit në vende të ndryshme, pavarësisht krimeve të tij?

Dr. Beáta Katrebová Blehová, Dr. Réka Földváryné Kiss, Velma Shariq dhe Lavinia Stan diskutuan në një sesion të moderuar nga Prof. Linda Kaljundi.

Dita e tretë e simpoziumit u përmyll me diskutimet në tryezë të rrumbullakët për të ardhmen e debateve historike europiane, që vlerësoi gjendjen aktuale të një kulture të përbashkët europiane të kujtesës, për të reflektuar mbi perspektivat e saj e debatet e mundshme historike në të ardhmen. Sesioni përmyllës trajtoi skenarë të mundshëm të konflikteve të ardhshme të rrënjosura në qasje të ndryshme lokale, rajonale, kombëtare, si dhe të brezave mbi përvojat historike.

Paneli me Prof. Maria Silvia Crăciun, Dr. András Fejérdy, Alicja Knast, u moderua nga Dariusz Rosiak.

Rafal Rogulsi, drejtues i ENRS e mbylli takimin, me ftesën për simpoziumin e radhës në Dublin.

NJOHJA NXIT STUDIMIN



PROJEKTIMI I "ARMIKUT TË POPULLIT" DHE IDEOLOGJIA E TJETËRIMIT TË INDIVIDIT

Studimi u përgatit nga Prof. Dr. Gjergj Sinani, Dr. Mirela Sinani, në kuader të konferencës ndërkombëtare shkencore "Fytyra e "Armikut" të popullit" të AIDSSH, në bashkëpunim ASA, ISKPK, IIPP dhe Muzeun Historik Kombëtar,

Trajtimi i problemeve të së shkuarës diktatoriale nuk është aq i lehtë sa duket. Edhe pas 30 vjetësh që Shqipëria ka pranuar sistemin demokratik, institucionet tona shtetërore që pretendojnë se janë demokratike, vijnë me një mungesë të theksuar vëmendjeje, kujdesi apo mbështetjeje për studime shkencore për të zbuluar të vërtetën historike të krimit komunist mbi popullin shqiptar.

Vërejmë se, sapo dalin fakte për krimin komunist dhe sapo çelet një diskutim nga më normalët për të kuptuar situatën përkatëse, mobilizohet një arsenal i tërë propagandistik në emër gjoja të kritikës objektive. Sigurisht kjo është një mënyrë tradicionale e përdorur gjatë diktaturës për t'i shkurajuar studiuesit dinjitozë të motivuar për kërkim shkencor dhe është një nga arsyet përse pak studiues qëndrojnë në këtë fushë kërkimi...

Fajtorë pa faj: Dënimi i inxhinierëve të kënetës së Maliqit, pjesë e justifikimeve për dështimet e regjimit komunist

Studimi u përgatit nga Prof. As. Dr. Sonila Boçi, në kuadër të aktivitetit perkujtimor "E vërteta për inxhinierët e Kënetës së Maliqit", hapjes dhe botimit të dosjes së tyre nga AIDSSH.

Situata politike në Shqipëri gjatë vitit 1946.

Viti 1946 shënoi një moment kthese në historinë e Shqipërisë, por edhe më gjerë. Kontradiktat ndërmjet Aleatëve të Mëdhenj, SHBA-së, Britanisë së Madhe, nga njëra anë, dhe Bashkimit Sovjetik, nga ana tjetër, po bëheshin gjithnjë e më të dukshme. Lufta ideologjike, shtrirja e zonave të influencës dhe imponimi i sistemeve të qeverisjes, kishte bërë që në Europë të binte ajo, që Ëillson Churchill-i do ta konsideronte "Perdja e Hekurt". Kjo situatë do të ndikonte drejtpërdrejt edhe në një vend të vogël si Shqipëria.

Sa i takon politikës së brendshme në Shqipëri, fitorja në zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese i dha një lloj qetësie udhëheqjes komuniste shqiptare. Ajo kishte përmbushur me këto zgjedhje objektivin e saj të parë, legjitimimin e pushtetit. Zgjedhjet kishin qenë kushti kryesor i Aleatëve Perëndimorë për ta njohur qeverinë e re shqiptare dhe për të vendosur me të marrëdhënie diplomatike. Shpallja e Republikës Popullore më 11 janar 1946 dhe miratimi i Statutit të saj më 14 mars të po atij viti, sanksionuan juridikisht programin e Frontit, por mandati popullor i "pushtetit popullor" mbetej i diskutueshëm për shkak të paketës ligjore me të cilën u organizuan zgjedhjet; rasteve të manipulimeve të rezultatit të tyre dhe, mbi të gjitha, për shkak të 20 deputetëve të çmandatuar, të burgosur apo të ekzekutuar gjatë asaj legjislature. Pavarësisht kësaj, zgjedhjet kishin hapur rrugën për të përmbushur objektivin e dytë edhe më të rëndësishëm, "vendosjen e një rendi të ri dhe mbajtjen e tij".



**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Adresa: Njësia administrative nr. 4, Rruga e Dibrës
Garnizoni "Skënderbej", Tiranë
<http://www.autoritetidoshjeve.gov.al>